



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 26 AKTI

NR. 42 VENDIMI

Tiranë më 18.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ina Serjanaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në Tiranë, më datë 17 qershor 2018, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Antoneta Sevdari**, prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioneren Valbona Sanxhaktari, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Antoneta Sevdari, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidatë për anëtare në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Relatore e çështjes u zgjodh me short znj. Alma Faskaj. Me vendimin nr.29, datë 23.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u vendos rishpërndarja e çështjeve të shortuara në datën 30.11.2017 me relatore znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës së komisioneres për një afat të pacaktuar, për arsye shëndetësore. Me shortin e hedhur në datën 23.05.2018 u caktua si relatore znj. Valbona Sanxhaktari, e cila deklaroi menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin.

Me vendimin e datës 13.12.2017, trupi gjykues ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtares Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

1. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, duke dërguar një raport të arsyetuar², ku ka konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.”*

Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 04.07.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 05.07.2018 mbi të drejtën e tij për të paraqitur shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit dhe për t'u njohur me dosjen. Subjekti i rivlerësimit nuk e ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen, por ajo paraqiti shpjegimet e saj. Znj. Antoneta Sevdari ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore më datë 13.07.2018. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55të ligjit nr.84/2016, më datë 17.07.2018, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë. Në përfundim të seancës, ajo kërkoikonfirmimin në detyrë.

¹ Raporti nr. *** prot., datë 16.11.2017 (15 fletë), në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

² Me shkresën nr. *** , datë 27.10.2018, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.01.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Antoneta Sevdari ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr.84/2016, si nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Ujësjiellës- Kanalizime Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, bankat e nivelit të dytë, etj;
- ç) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Mbas verifikimit administrativ të kryer nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, rezulton:

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, subjekti deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Pasuria tokë, 350 m², në bashkëpronësi të shtetasve A. S., I. S., dhe K. B. Pronë e blerë në vitin 2001, në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë⁴.

Burimi i krijimit sipas Deklaratës-Vetting: *Kursime familjare të bashkëshortit të krijuara kryesisht nga puna si emigrant në Greqi, në vitet 1997 - 2000.*

- Hetimi i kryer nga Komisioni⁵: Në lidhje me këtë pasuri u verifikua origjina e pronës në ZRPP⁶.

Konstatohet se kjo pasuri është blerë nga familja e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me qëllim ndërtimin e një shtëpie banimi, familjare. Në këtë kohë, subjekti i rivlerësimit nuk kishte nisur ta ushtronte ende detyrën e prokurorit.

Më datë 22.05.2009, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, edhe me pëlqimin e saj, ka shitur 2/3-tën pjesë të kësaj pasurie, respektivisht nga 1/3-tën pjesë shtetasve N. B., dhe I. S., në shumën 69.300 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind) lekë. Blerësit rezultojnë të jenë në marrëdhënie familjare me subjektin e rivlerësimit, përkatësisht vëllai i bashkëshortit të subjektit, si dhe kunati i saj (bashkëshorti i motrës së personit të lidhur). Në vitin 2009, nga subjekti është deklaruar pakësimi i kësaj pasurie. Nga shpjegimet⁷ që ka dhënë subjekti i rivlerësimit, ka sqaruar se që prej fillimit kjo tokë u ble për ndërtimin e një shtëpie të përbashkët familjare (prindërit dhe fëmijët). Shitja në vitin 2009 është bërë për efekt të ndarjes së pjesëve, me qëllim legalizimin/regjistrimin e banesës në mënyrë proporcionale.

Më tej, me kontratë dhurimi nr. *** rep., nr.*** kol., datë 31.12.2015, pasuria ka kaluar në bashkëpronësi të K. N. B., I. H. S., dhe A. H. S.

Nga subjekti është deklaruar se të gjitha këto veprime janë bërë mes familjarëve, të cilët që prej fillimit kishin planifikuar të blinin një truall për të ndërtuar një shtëpi banimi së bashku.

Komisioni hetoi edhe në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Subjekti, pasi është pyetur, ka deklaruar se *“kjo sipërfaqe toke është blerë nga kursimet familjare që kishin të gjithë së bashku, familja e bashkëshortit (kursime të cilat kanë ardhur kryesisht nga të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion në Greqi e bashkëshortit (shtator 1997 - prill 2000), si dhe kursime të prindërve të tij nga puna në familjen e tyre bujqësore)”*⁸, periudhë kjo, kur subjekti i rivlerësimit nuk ishte ende në lidhje me bashkëshortin e saj.

Subjekti ka depozituar disa dokumente: *kërkesa për blerje pullash sigurim për muajt qershor, korrik, gusht 1998; kartë qëndrimi me afat kohor të kufizuar, me nr.120633; si dhe vërtetim, datë 27.01.1998* –për të provuar se personi i lidhur, bashkëshorti i saj, z.A. S., ka qenë në Greqi në atë periudhë.

2. Shtëpi banimi, e ndërtuar mbi këtë truall në mënyrë informale gjatë viteve 2001 -2002, në emër të shtetasve A. S., I. S., dhe N. B., regjistruar si pasuria me nr. **, zona kadastrale nr.**, Yzberisht, Tiranë, legalizuar me lejen e legalizimit nr.**, datë 17.09.2013. Pjesa zotëruese është kati i dytë i ndërtesës dhe një e treta e katit përdhe. Shpenzuar për ndërtimin e pjesës zotëruese, vlera 3.000.000 (tre milionë) lekë.

- Hetimi i kryer nga Komisioni:⁹

Në lidhje me këtë pasuri rezulton se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në vitin 2006 një vetëdeklarim¹⁰ për legalizimin e objektit, shtëpi e ndërtuar në

⁴ Me kontratë shitblerjeje nr.*** rep., *** kol., datë 12.07.2011, nga A. S., në vlerën 700.000 lekë.

⁵Referojuni në dosje korrespondencës me ZVRPP-në Tiranë, nr. ***prot., datë 26.01.2018, nr. *** prot., datë 08.01.2018, etj.

⁶ Rezulton se pasuria nr.*** e llojit “Arë”, e ndodhur në Yzberisht, Tiranë, ka qenë në emër të shtetasit B. N., në sipërfaqe 350 m², sipas certifikatës së datës 11.07.2001.

⁷Referojuni përgjigjeve (nr.*** prot., datë 27.02.2018) të pyetësorit, dërguar subjektit nga Komisioni me e-mail-in e datës 20.02.2018.

⁸Referojuni përgjigjeve (nr.***prot., datë 27.02.2018) të pyetësorit, dërguar subjektit nga Komisioni me e-mail-in e datës 20.02.2018.

⁹ Referojuni në dosje korrespondencës me ZVRPP-në Tiranë, nr. *** prot., datë 26.03.2018, dhe Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t.

¹⁰Referojuni dokumentit të administruar në dosje.

vitin 2002, 4-katëshe, me sipërfaqe të zënë 350 m², sipërfaqe ndërtimi 110 m², lartësi e objektit 12 m. Nga verifikimi që u krye në zyrat e ALUIZNI-t rezultoi se shtetasi A. S., ka aplikuar në njësinë e qeverisjes vendore Kashar në vitin 2006. Referuar bazës dixhitale qendrore të të dhënave, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, u vërejt se ai ka aplikuar për legalizimin e banesës me të dhëna: numri i familjeve 3, numri i banorëve 13, viti i ndërtimit 2002, numri i kateve mbi tokë 4, certifikata familjare 3¹¹. Sipas këtij informacioni, rezulton se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, ka paraqitur tri certifikata familjare dhe se, që prej fillimit, ky aplikim ka qenë për të gjithë bashkëfamiljarët e deklaruar se kanë ndërtuar këtë shtëpi së bashku.

Për këtë pasuri është dhënë leja e legalizimit nr. ***, datë 17.09.2013, në emër të personit të lidhur dhe dy bashkëpronarëve të truallit, përkatësisht z. N. B., dhe z. I. B.

- ZVRPP ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie sipas lejes së legalizimit.
- Rezulton se ndërtimi i kësaj pasurie është realizuar në kohën kur subjekti nuk kishte nisur ushtrimin e detyrës së prokurores.

Komisioni hetoi edhe në lidhje me aftësinë financiare për ndërtimin e kësaj pasurie:

Për shkak se ndërtimi daton përpara vitit 2003, subjekti është pyetur mbi burimin e të ardhurave të bashkëshortit të saj për ndërtimin e kësaj banese.

Në përgjigjen e dhënë¹², subjekti ka sqaruar se të ardhurat për ndërtimin e kësaj pasurie kanë qenë ato të përmendura në pasurinë e parë (të ardhura nga emigracioni), por edhe *të ardhurat e bashkëshortit nga puna në Arabinë Saudite, në vitin 2003, për 5 muaj, në shumën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) euro, nga shoqëria "***" sh.p.k.*

*Komisioni¹³ i ka kërkuar informacion shoqërisë "***" mbi kontratën e shërbimit lidhur me z. Sevdari, si dhe kopje të pagesave të kryera në favor të tij.*

Në përgjigjen e dhënë¹⁴, shoqëria ka informuar se ka pasur një kontratë të rregullt pune me z. A. S., për shërbimet e kryera në shtetin e Arabisë Saudite për një periudhë pesëmuajore, qershor - dhjetor 2003, por për këtë nuk disponon kopje të kontratës së bashkëpunimit, pasi kanë kaluar shumë vite dhe shoqëria nuk ka mundur t'i ketë.

➤ Nga verifikimi i kësaj pasurie (shtëpi banimi dhe truall), vërehet se toka është blerë në vitin 2001, me qëllim ndërtimin më tej të një banese të përbashkët familjare të z. A. S., me prindërit, motrën dhe vëllain, me të ardhura të përfituara kryesisht nga emigracioni në vitet 1997-2000. Shtëpia është ndërtuar me kontributin e përbashkët të pjesëtarëve të kësaj banese (përkatësisht sipas pjesëve) dhe është aplikuar për legalizim në fillesat e këtij procesi, viti 2006. Nga verifikimi rezultoi se që prej fillimit ata kanë aplikuar sëbashku për legalizimin e kësaj prone (3 familje). Kjo pronë është legalizuar në vitin 2013 dhe regjistruar në zyrën e hipotekës në Yzberisht.

Kjo pasuri iu nënshtrua një hetimi të plotë nga Komisioni dhe rezultoi se përputheshin deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit. Për këtë pasuri, znj. Sevdari ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion, i cili e ka bindur trupin gjykues lidhur me krijimin e kësaj pasurie, herët në vitet 2000-2002, nga bashkshorti i subjektit të rivlerësimit dhe familjarët e tij. Znj. Antoneta Sevdari fillimisht nuk ka qenë pjesëtare e kësaj familjeje, më tej ajo ka qenë studente e magjistraturës dhe nuk ushtronte funksionin e prokurores. Ajo nuk ka kontribuar në blerjen e kësaj pasurie dhe as investuar për ndërtimin e saj.

¹¹ Referojuni për më tepër praktikës nr.*** prot., datë 22.06.2018, të ALUIZNI-t.

¹² Referojuni përgjigjeve (nr.*** prot., datë 27.02.2018) të pyetësorit dërguar subjektit nga Komisioni, me e-mail-in e datës 20.02.2018.

¹³ Me shkresën nr.*** prot., datë 22.01.2018.

¹⁴ Referojuni shkresës nr.*** prot., datë 24.01.2018.

3. Apartament, me sipërfaqe 101 m², (+ 12 metra ambiente të përbashkëta) në emër të z. A. S., regjistruar si pasuria me nr. *, zona kadastrale nr.***, sipas kontratës noteriale nr.*** prot., nr.*** kol., datë 19.09.2011, me vlerë 97.500 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) euro.**

Burimi i krijimit, sipas Deklaratës-Vetting: *Kursime familjare të krijuara kryesisht nga pagat dhe fitimi i bashkëshortit si person fizik, inxhinier gjeodet.*

- Hetimi i kryer nga Komisioni¹⁵ në lidhje me këtë pasuri: Sipas praktikës së ZVRPP-së Tiranë¹⁶, pasuria e ka origjinën e saj me vërtetimin e pronësisë nr.***, datë 05.06.2009, në emër të shoqërisë “***” sh.p.k. Apartamenti përshkruhet: pasuria me nr.*** e ndodhur në zonën kadastrale ***, me sipërfaqe 101.0 m², në katin e gjashtë, në kullën ***, në godinën polifunksionale 3, 8 dhe 9 kat, me 2 kate parkim nëntokë, në ***.
- ZVRPP Tiranë ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie në emër të subjektit, si dhe kohën e blerjes së kësaj pasurie.

Komisioni hetoi në lidhje me aftësinë paguese për këtë pasuri¹⁷:

Nga analiza ekonomike e kryer nga Komisioni lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe komunikimi me subjektin e rivlerësimit, mbi saktësimin e të ardhurave dhe burimit të tyre të ligjshëm, ka rezultuar se ata kanë pasur të ardhura për blerjen e kësaj pasurie¹⁸.

Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit u konstatua se ata kishin likuiditete të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i deklarimit ka shpjeguar gjithashtu se: “... bashkëshorti deklaroi se po të këqyrësh statment-in bankar të llogarive në euro apo në lek, të cilat janë shtuar gjatë viteve 2009 apo 2010, rezulton qartë se burimi i vetëm i të ardhurave në llogarinë bankare është likuidimi i faturave të lëshuara për shoqëritë tregtare, për të cilat ai ka ofruar punën (shërbimin) si inxhinier gjeodet. E thënë me fjalë të tjera, këto llogari bankare janë kredituar vetëm nga të ardhurat e siguruar nga puna e tij.”

- Vërehet se subjekti ka pasur aftësi paguese për blerjen e kësaj pasurie. Përputhen deklarimet e subjektit me rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni.

4. Automjet, me targë*, në emër të Antoneta Sevdarit, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.11.2015, në shumën 6.000 (gjashtë mijë) euro, në pjesë takuese 100 %.**

Burimi i krijimit, sipas Deklaratës-Vetting: *Kursime familjare.*

- Hetimi i kryer nga Komisioni: DPSHTRR¹⁹ ka konfirmuar pronësinë e automjetit në emër të subjektit të rivlerësimit sipas deklarimit të bërë prej saj.
- Nga analiza ekonomike e kryer nga Komisioni, lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë blerje.

5. Automjet “Mercedes-Benz”, me targë*, në emër të personit të lidhur/ bashkëshortit, z. A. S., sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.10.2014. Vlera e blerjes + vlera**

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2017, drejtuar ZVRPP-së Tiranë. Shkresë nr. *** prot., datë 26.03.2018, e ZVRPP-së Tiranë. Shkresë nr.***, datë 13.03.2018, drejtuar ZVRPP-së. Shkresë nr.*** prot., datë 29.03.2018, e ZVRPP-së Tiranë. Shkresë nr. *** prot., datë 11.01.2018, drejtuar OSHEE-së. Shkresë nr. ***prot., datë 26.02.2018, e OSHEE-së. Shkresë nr. *** prot., datë 21.03.2018 drejtuar OSHEE-së. Shkresë nr.***prot.(s'ka datë), e OSHEE-së.

¹⁶Nr.***prot., datë 29.03.2018, e ZVRPP-së Tiranë.

¹⁷Referojuni përgjigjeve (të subjektit) të e-mail-it të datës 25.06.2018, si dhe dokumenteve bashkëngjitur.

¹⁸Shiko analizën financiare në dosje.

¹⁹Me shkresën nr.*** prot., datë 28.12.2017.

e zhdoganimit +shpenzime transporti 5.500 (pesë mijë e pesëqind) euro (4.200 euro kontrata, 1000 euro zhdoganimi, + 300 euro transporti) në pjesë takuese 100%.

- Hetimi i kryer nga Komisioni: DPSHTRR²⁰ ka konfirmuar pronësinë e automjetit në emër të subjektit të lidhur sipas deklaramit të bërë prej tij.

Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni kreu analizën financiare mbi të ardhurat, shpenzimet, likuiditetet, diferencat etj., për vitin 2014.

➤ Rezulton se personi i lidhurz.Sevdari, ka pasur mundësi financiare për këtë blerje.

6. Komisioni hetoi në lidhje me të ardhurat e deklaruara në deklaratën e pasurisë për vitin 2006, të krijuara nga puna e bashkëshortit si inxhinier pranë “***” në Arabinë Saudite, në vlerë 18.970 (tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) USD.

Komisioni ka konstatuar se në emër e për llogari të subjektit të rivlerësimit në vitin 2006 janë kryer dy transfertat në llogarinë e saj në monedhën USD, në “Procredit Bank”, përkatësisht në vlerën 10.000 USD (9.982 USD) më datë 28.04.2006 dhe 10.000 USD (9.982 USD) më datë 13.07.2006.

Komisioni ka mbajtur korrespondencë me “ProCredit Bank”²¹, nga ku është konfirmuar urdhëruesi i transfertave.

➤ Deklarimi i subjektit është në përputhje me përgjigjen e dhënë nga “ProCredit Bank”.

7. Komisioni hetoi në lidhje me të ardhurat e deklaruara në deklaratën e pasurisë për vitin 2008 për personin e lidhur, bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

Në këtë vit, subjekti ka deklaruar 1.835.000 (një milion tetëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë të ardhura të krijuara nga puna e bashkëshortit si person fizik, inxhinier gjeodet, me nr.NIPT ***. Nga “Raiffeisen Bank” janë konfirmuar arkëtime për këtë vit në vlerën 1.839.170 (një milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë. Për të vërtetuar nëse qarkullimi ka qenë deri në 2.000.000 (dy milionë) lekë dhe jo më tepër, është mbajtur korrespondencë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe njëkohësisht është pyetur edhe subjekti.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka informuar se z. A. S., është regjistruar në QKB më datë 11.04.2008, me qarkullim zero, fitim të realizuar zero. Ky informacion rezulton në përputhje me ligjin nr.***, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", në të cilin është parashikuar se subjektet të cilat kanë pasur një qarkullim vjetor 0-2.000.000 lekë, nuk kanë qenë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe as subjekt i tatimit mbi fitimin.

Për këtë konstatim Komisioni ka pyetur edhe subjektin e rivlerësimit, mbi vlerën e fitimit neto dhe tatimin që bashkëshorti i saj ka paguar mbi të ardhurat e krijuara nga puna e tij si person fizik, në vlerën 1.835.000 (një milion tetëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.

Subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se²²:

“... Në vitin 2008 është regjistruar për herë të parë si person fizik, në kategorinë e biznesit të vogël me qarkullim 0-2.000.000 lekë. Sipas legjislacionit të kohës, bizneset e kësaj kategorie nuk bënin bilanc²³, sepse detyrimet tatimore që paguante kjo kategori biznesi ishin fikse dhe nuk varehin nga fitimi neto, madje as nga qarkullimi brenda kësaj fashe. Kjo kategori i

²⁰ Me shkresën nr.*** prot., datë 28.12.2017.

²¹ Referojuni korrespondencës së mbajtur me “ProCredit Bank”, përkatësisht shkresës nr. *** prot., datë 22.01.2018, të Komisionit; nr. *** prot., datë 02.02.2018, të “ProCredit Bank”; nr.***prot., datë 26.02.2018, të “ProCredit Bank”; nr. *** prot., datë 26.02.2018 të “ProCredit Bank”; nr.*** prot., datë02.03.2018 të Komisionit, nr.***, datë 06.03.2018, të “ProCredit Bank”.

²² Referojuni në dosje përgjigjeve të pyetësorit të datës 16.04.2018.

²³ Nuk kishin detyrim ligjor të bënin bilanc dhe as pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve.

nënshtrrohej vetëm pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël mbi qarkullimin, e cila për fashën 0-2.000.000 lekë ishte fikse.

Ndërsa në nenin 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" "Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël", parashikohet se:

"...Niveli tregues i taksës, për çdo kategori biznesi, në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1 milion lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2 milionë lekësh, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal tregues është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi."

Për këtë deklaram subjekti ka bashkëlidhur shkresën e dërguar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë e Tiranës²⁴.

Sipas shkresës së Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, me nr. ***prot., datë 19.04.2018, rezulton se subjekti fizik A. S., me NIPT ***, në vitin 2008 ka deklaruar qarkullim vjetor 0-2.000.000 lekë dhe ka paguar tatimfitim të thjeshtuar, 3 këste, nga 9.500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë secili, në vlerën 28.500 (njëzet e tetë mijë e pesëqind) lekë.

➤ Konstatohet se të ardhurat e krijuara nga personi i lidhur janë të ligjshme, në përputhje me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

8. Komisioni hetoi në lidhje me të ardhurat e deklaruara në deklaratën e pasurisë për vitin 2013 nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

Hetimi i kryer nga Komisioni: Për vitin 2013, personi i lidhur ka deklaruar fitim neto si person fizik në vlerën 937.738 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë.

Nga veprimet bankare në "Raiffeisen Bank"²⁵ janë konstatuar arkëtime në vlerë rreth 40.000 (dyzet mijë) euro në llogarinë e personit të lidhur si person fizik. Sipas përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve²⁶, gjatë këtij viti, fitimi neto i biznesit ka qenë në vlerën 937.738 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë. Për të saktësuar të dhënat, u mbajt korrespondencë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Me shkresën nr.*** prot., datë 19.03.2018, Komisioni i ka kërkuar këtij institucioni kopje të bilancit, si dhe librat e blerjes dhe shitjes për këtë vit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr.***prot., datë 18.04.2018, informon se shitjet e deklaruara për vitin 2013 kanë qenë në vlerën 4.837.477 (katër milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë dhe për këtë ka dërguar edhe librat e shitjes, si dhe tabelën përmbledhëse të të ardhurave, shpenzimeve dhe fitimeve të këtij viti. Konstatohet se kjo vlerë është në një linjë me arkëtimet në vitin 2013, në llogarinë e personit të lidhur.

➤ Përputhet deklarimi i subjektit me informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

9. Gjendje në llogarinë bankare në lek, në "Credins Bank", në emër të Antoneta Sevdarit, në shumën 8.100 (tetë mijë e njëqind) lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni: "Credins Bank"²⁷ ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje më datë 25.01.2017: 8.166 (tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë. Kjo llogari kreditohet nga paga e subjektit.

²⁴Referojuni në dosje dokumentit bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit të datës 16.04.2018.

²⁵Referojuni në dosje korrespondencës me "Raiffeisen Bank".

²⁶Referojuni në dosje korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

²⁷Me shkresën nr.***, datë 16.02.2018.

➤ Nga verifikimi i *statement*-it të dërguar nga “Credins Bank”, rezulton se subjekti ka qenë e saktë në deklarinimin e saj.

10. Gjendja *cash* në banesë, 6.000 (gjashtë mijë) euro.

Burimi i krijimit, sipas Deklaratës-Vetting: *Kursimet familjare*.

Hetimi i kryer nga Komisioni: Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni kreu analizën financiare mbi të ardhurat, shpenzimet, likuiditetet, diferencat etj., për vitin 2016.

➤ Rezulton se subjekti ka pasur aftësinë për të krijuar këto likuiditete.

11. Gjendja në llogarinë bankare rrjedhëse, në euro, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit, z. A. S., në shumën 23.559 (njëzet e tre mijë epesëqind e pesëdhjetë e nëntë) euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni: “Raiffeisen Bank”²⁸ ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i *statement*-it të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

12. Gjendja në llogarinë bankare rrjedhëse në lek, në BKT, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit, z. A. S., person fizik me NIPT *, në shumën 24.257 (njëzet e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.**

Hetimi i kryer nga Komisioni: “BKT”²⁹ ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje prej 23.890 (njëzet e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekësh, në datën 25.01.2018. Nga verifikimi i *statement*-it të dërguar nga “BKT”-ja, konstatohet se subjekti ka qenë e saktë në deklarinimin e saj.

13. Gjendja në llogarinë bankare rrjedhëse, në euro, në BKT, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit, z. A. S., person fizik, me NIPT *, në shumën 47 (dyzet e shtatë) euro.**

Hetimi i kryer nga Komisioni: “BKT”³⁰ ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, me gjendje prej 45 (dyzet e pesë) eurosh, në datën 25.01.2018. Nga verifikimi i *statement*-it të dërguar nga “BKT”-ja, konstatohet se subjekti ka qenë e saktë në deklarinimin e saj.

14. Detyrime të papaguara nga shoqëria “*” për personin fizik, personin e lidhur/bashkëshortin, z. A. S., me NIPT ***, faturë e papaguar për muajin dhjetor në shumën 4.000 (katër mijë) euro. Nga verifikimi i faturës³¹, konstatohet se subjekti ka qenë e saktë në deklarinimin e saj.**

Konkluzione për komponentin e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficiencës dhe proporcionalitetit, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, pasi vlerësoi provat dhe shpjegimet e paraqitura dhe i analizoi ato, arrin në përfundimin se:

Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u konstatua se deklarinimet e saj janë bindëse, të sakta dhe në përputhje me ligjin. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

²⁸ Me shkresën nr. ***prot., datë 20.12.2017.

²⁹ Me shkresën nr. ***prot., datë 03.01.2018.

³⁰ Me shkresën nr. ***prot., datë 03.01.2018.

³¹ Datë 30.12.2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari”. Ky raport është deklasifikuar³² në datën 08.01.2018.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzione për komponentin e vlerësimit të figurës

Trupi gjykues konstaton se nga hetimi administrativ, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokurore.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr.***prot., datë 16.01.2018.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga vlerësimet e punës së subjektit Antoneta Sevdari për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ajo është vlerësuar “shumë mirë”. Kjo tregon për aftësitë profesionale të saj, si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht, ashtu dhe në menaxhimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që ka pasur në ndjekje.

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Antoneta Sevdari, shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në vijimësi, ajo e analizon normën penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me norma të ligjit penal dhe procedural.

Në lidhje me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal, sipas normës penale relevante, si dhe përdor parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, siç është edhe e drejta e ankimit.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota, të konfirmuara edhe nga vlerësimet “Shumë mirë” të Prokurorit të Përgjithshëm, për vitet 2014, 2015, 2016.

Ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, si për ngritjen e nivelit të saj profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

³²Vendim nr.8, datë 08.01.2018.

b) Arsyetimi ligjor

Bazuar në 3 aktet e dorëzuara dhe në 5 dosjet e shortuara për subjektin Antoneta Sevdari, konstatohet mënyra e qartë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas ligjit. Vendimmarrja e prokurorit, subjekt vlerësimi, e pasqyruar në pjesën arsyetuese është e qartë dhe e kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazë ligjore. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori, ku konstatohet se në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

Në qëndrimet e mbajtura dhe kërkimet e prezantuara para gjykatës, përmes dhe diskutimeve përfundimtare, rezulton të jenë të arsyetuara, ku konstatohet të ketë ruajtur një raport të drejtë mes interesit publik, interesit të të dëmtuarve nga vepra penale/viktimize, interesave të organit të akuzës dhe në mosshkeljen e të drejtave dhe lirive personale të të gjykuarve, fakte apo cilësi që janë marrë në konsideratë lidhur me vlerësimin “*Shumë mirë*” për tri vitet e fundit.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Duhet theksuar se në vlerësimin profesional mbahet parasysh fakti që subjekti i rivlerësimit ka punuar në një sektor (ai për krimet në fushën ekonomike, të pastrimit të produkteve të veprave penale, të krimeve në detyrë, korrupsionit etj.), ku çështjet në ndjekje janë nga vetë natyra e tyre shumë komplekse, e ndërkohë kërkohet angazhim dhe impenjim i madh si dhe kohë efektive, sepse këto kategori veprash penale janë konsideruar prioritet nga organi i Prokurorisë dhe nga vetë qeveria shqiptare, nëpërmjet rekomandimeve që jep çdo fillimviti me anë të ministrit të Drejtësisë.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti Antoneta Sevdari ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet, si dhe ka drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve, ndërkohë që këto fakte janë prezantuar dhe në vlerësimin e saj përgjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, ku vlerësimi për këto vite ka qenë “*Shumë mirë*”.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Antoneta Sevdari, ka vepruar në dinamikë, duke kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore dhe në kohë të arsyeshme. Nga ana e saj është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim, si dhe sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit, e faktuar kjo me shkresat përkatëse ose me nënshkrimin e tyre në aktet përkatëse, cilësi këto të pasqyruara dhe në vlerësimet e bëra ndaj saj, nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre, sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta e të strukturuar.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë nga ana e prokurores është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Antoneta Sevdari, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Subjekti, gjatë periudhës së rivlerësimit, nuk ka pasur masa disiplinore.

c) Paanësia

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin Antoneta Sevdari, për periudhën objekt rivlerësimi, nuk rezultojnë të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe të papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar cenimi i të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerable, grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe pakicave, ku nuk është përdorur gjuhë diskriminuese dhe çdo element tjetër që lidhet me paanësinë.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Komunikimi, bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratën, konstatohet të kenë qenë korrekte. Konstatohet të ketë shfaqur kompetencë profesionale për çështje të ndryshme. Konstatohet se është e hapur në ndarje të përvojës me kolegët.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Subjekti ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe është e gatshme të punojë në grup. Është e hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Kjo është shfaqur edhe në vlerësimin e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, lidhur me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, ku rezultojnë se është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, ka marrë titullin “Jurist” më datë 10.07.1999, në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Është diplomuar pranë Shkollës së Magjistraturës me nr. 16/B të diplomës si magjistrat-prokuror. Ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor 2000 - tetor 2003.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, ka marrë titullin “Administrator biznesi” më datë 25.12.2006, në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës.

❖ Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore)

Referuar të dhënave arkivore pranë sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, për prokuroren Antoneta Sevdari, subjekt rivlerësimi, rezulton se nuk ka të dhëna që kanë të bëjnë me ankesa dhe masa disiplinore të marra gjatë periudhës së vlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, për periudhën e vlerësimit ka të arkivuara në sektorin e burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme vlerësimet e punës “*Shumë mirë*”, të kryera për tri vitet e periudhës së rivlerësimit nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42, të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”.

❖ Lidhur me pesë dosjet e përzgjedhura me short për vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, pas verifikimit nga Komisioni, lidhur me rastin 5 të trajtuar në raportin e vlerësimit profesional, konstatohet se:

Në vitin 2015 është regjistruar procedimi penal nr. 4810 ndaj të pandehurit G.D., hetuar në gjendje të lirë për akuzën e veprës penale, refuzim për deklarim/mosdeklarim/fshehje ose deklarim i rremë i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, parashikuar nga neni 275/a/1 i Kodit Penal. Kjo çështje është dërguar për gjykim më datë 25.02.2016. I gjithë procesi ka qenë i mbështetur mbi materialin kallëzues të ILDKPKI-së. Nga veprimet hetimore konstatohet se prokurori ka kryer veprimet hetimore të duhura, dhe në diskutimet përfundimtare më datë 01.06.2016 ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të referuar. Me aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale përfundimisht ka kërkuar dënimin e të pandehurit me 4 muaj burgim. Gjykata e Shkallës së Parë, me vendimin e saj nr.2047, datë 21.06.2016, në prezencë të prokurorit, ka vendosur pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit G.D. Sipas verifikimeve rezulton se vendimi është zbardhur, dosja është dorëzuar brenda afatit ligjor të parashikuar, për të ushtruar secila nga palët të drejtën e ankimit.

Konstatohet se në këtë rast subjekti i rivlerësimit nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit. Nga ana e subjektit të rivlerësimit, më datë 07.07.2016 është bërë një kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit për një rast faktor, sikurse është shprehur vetë prokurori, e dokumentuar kjo me dokumentacion.

Gjithashtu, në kërkesën për rivendosje në afat, subjekti i rivlerësimit ka parashikuar se ditët e para të dhënies së vendimit është pritur zbardhja e tij, me qëllim të depozitohet ankimi i arsyetuar. Ky fakt është sqaruar në analizën e provave që i përket vendimit të pushimit.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e saj nr. 982 akti, datë 25.10.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit pranë gjykatës dhe, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “*Gjykata krijon bindjen se nuk kemi të bëjmë as me rast faktor dhe as me forcë madhore.*”

Sipas fletës së numërorit të vendimeve rezulton se dosja është depozituar në sekretari brenda afatit dhe nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë depozituar ankim nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, në seancën dëgjimore, lidhur me këtë konstatim, është shprehur:

“E dëgjova me kujdes raportin. Konstatoj që ai është i drejtë...Është i drejtë edhe konstatimi i mosushtrimit të apelit për rastin e të pandehurit G.D. Siç është shpjeguar dhe në komunikimin tim me ju, – në mënyrë elektronike, pas njohjes me rezultatet e hetimit, – kjo ka ndodhur për shkak se ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme që unë gjatë kësaj periudhe kohore të kujdesesha për një familjar timin, i cili ishte i sëmurë rëndë, në kushtet kur dhe babai i mbesës ishte i sëmurë rëndë. Menjëherë sapo unë kam konstatuar, kam mbledhur dokumentacionin e nevojshëm dhe kam bërë kërkesë, ashtu siç u deklarua dhe në këtë seancë

dëgjimore, për rivendosje në afat, kërkesë e cila u çmua nga Gjykata e Shkallës së Parë që nuk i përmbushte kushtet e rastit faktor.

Në këtë moment unë jam njohur më thellësisht me praktikën gjyqësore dhe kam folur dhe me prokurorë të Apelit dhe si konkluzion është arritur në përfundimin që rasti që unë paraqita para gjykatës, në fakt nuk përbënte rast faktor. Praktika gjyqësore e lidhte rastin faktor me raste të rënda të vetë subjektit të rivlerësimit, siç mund të ishin aksidente traumatike në gjendje kome apo sulme kriminale që e mbanin vetë subjektin që kishte të drejtën procedurale të ankimit të izoluar dhe e çonin atë në pamundësi objektive. Kur u binda se pavarësisht se kisha shkak njerëzor që nuk bëra apelin, ai nuk përbënte shkak faktor dhe për këtë arsye nuk vazhdova më tej, sepse mendova që nuk ishte më efektive.”

Në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 10 denoncime³³ të depozituara pranë Komisionit.

Pas hetimit të raportit të Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimeve, nuk u gjet asnjë indice apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores, znj. Antoneta Sevdari.

Konkluzione për komponentin e vlerësimit profesional

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) gjetjet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr.84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kreun II të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe konsiderohet: “E aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, mbështetur në parimin e efiçencës dhe proporcionalitetit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

³³Datë 03.12.2017, nr.*** prot.; datë 12.12.2017, nr.*** prot.; datë 02.02.2018, nr.*** prot.; datë 12.06.2018, nr.*** prot.; datë 16.01.2018, nr.***prot.; datë 23.01.2018, nr.*** prot.; datë 19.02.2018, nr.*** prot.; datë 25.05.2018, nr.*** prot.; datë 12.06.2018, nr.***,datë 7.06.2018.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, me funksion prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 18.07.2018, ora 11:00.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes Shuli
Kryesues

Valbona Sanxhaktari
Relator

Roland Ilia
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ina Serjanaj